



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:144110

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05595981

KF.nr.220/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me Gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit N.T.SH. “T...M...” B.I me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti – ndëshkim tatimor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 12.04.2024, të mbajtur në prani të paditësit-pronarit Y.S., dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.SH. “T...M...” B.I me seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Vendimi nr.prot. 103/2021 i datës 07.05.2021, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 05.07.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit ATK-ë, duke kërkuar të aprovet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi nr. 103/21 i datës 07.05.2021, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet tërësisht pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Ka shtuar se për shkak të arsyeve shëndetësore të cilat dëshmi i janë ofruar gjykatës nuk ka qenë prezent gjatë vizitës të të paditurës. Me shkresën e datës 26.05.2021 të paditurës i është drejtuar me shkrim me kërkesë që ti lejoj përmirësimin e deklaramit tatimor,

mirëpo nga e njëjta nuk ka marrë përgjigje. Më tej thekson se vendimin e kontestuar e kundërshton për shkak të shkeljes esenciale të procedurës administrative, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimi të gabuar të së drejtës materiale. Gjykatës i ka kërkuar që pas administrimit të provave të aprovohet kërkesëpadia dhe të anulohet vendimi i kontestuar duke e liruar paditësin nga gjoba dhe nga vlera e tatimit të konstatuar nga kinse mungesa e mallit apo të lejohet korigjimi i deklaratës tatimore sa i përket TVSH për periudhën 02.2021 apo çështja të kthehet në rivendosje tek organi i paditur.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 07.04.2021, kundërshton pretendimet e paditësit dhe konstaton se vendimi kontestues është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm. Shton se ATK-ja ka bërë vizitë te tatimpaguesi me datë 10.03.2021 ku është vërtetuar se tatimpaguesi nuk ka mbajtur librat dhe regjistrimet ashtu siç kërkohet me dispozitat e legjislacionit tatimor, gjegjësisht paditësi nuk ka bërë në mënyrë të rregullt regjistrimin e mallit dhe gjatë vizitës është konstatuar se ka mungesë të mallit dhe për këtë parregullsi tatimpaguesi tani paditësi është ndëshkuar në bazë të nenit 53 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.03/L-222, në vlerë prej 125.00 € bazuar në vizitën e datës 10.03.2021. Mbështetur në dispozitat ligjore, vërtetimin e gjendjes faktike si dhe interpretimin e drejtë të dëshmimeve tjera si në shkresat e lëndës, ATK-ja i propozon Gjykatës Komerciale – Departamenti Fiskal që pas administrimit të provave dhe analizimit të dispozitave ligjore relevante, ta refuzojë si të pa bazuar padinë e paditësit duke lënë në fuqi vendimin e DA nr.103/2021 datë 07.05.2021. E paditura nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor ndonëse e njëjta e ka pranuar ftesën për seancë, ndërsa me parashtresën e datës 05.04.2024 e njëjta e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoi në seancë duke kërkuar nga gjykata që të vepron në pajtim me nenin 38 par.5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Forma për vizita përmbushëse, Vendimi i ZGJONA 0260/2021 i datës 16.03.2021, Ankesë e paditësit, Vendimi 103/2021, Shkresë e paditësit pranuar nga ATK me datë 26.05.2021, Raportet mjekësore, Përgjigja në padi e datës 07.04.2023, Lista e ndëshkimeve datë 30.03.2021, Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe e transaksioneve tjera e datës 15.03.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe

të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklaratimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor Kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se i padituri me datë 10.03.2021 ka realizuar vizitë përmbushëse tek subjekti në procedurë këtu paditësi, ku është ndëshkuar nga inspektori tatimor sipas Vendimit nr.0260, tutje se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK-ë me datë 23.03.2021, e për të cilën ankesë, ATK-ja me datë 07.05.2021, ka marr vendimin nr. 103/21, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 05.07.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ në këtë gjykatë.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Departamenti i Ankesave – Administrata Tatimore e Kosovës e ka vërtetuar se kontesti i tatimpaguesit për lëshimin e ndëshkimit të lëshuar për mos mbajtje të librave dhe regjistrimeve është i pa bazuar, pasi që bazuar në vizitën e kryer nga inspektori tatimor me datë 10.03.2021 është verifikuar se i njëjti nuk ka mbajtur m rregull regjistrimin e mallit të datës 31.12.2020 duke konstatuar mungesë të mallit në vlerë prej 288,572.72€, andaj tatimpaguesi rekomandohet të deklaroj mungesën e mallit të cilën i njëjti e ka kryer me faturën nr.1-6534 nga data 04.02.2021 për periudhën tatimore 02/2021. ATK-ja pasi ka konstatuar parregullsi të mos mbajtjes së gjendjes së mallit me rregull, ekipi Zgjonë bazuar në verifikimet e kryera nga inspektori me vizitën e datës 10.03.2021 ka ndëshkuar tatimpaguesin në vlerë prej 125.00€ në bazë të nenit 53 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 03/L-222 i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjit nr. 04/L-102 dhe 04/L-223 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e

paditësit të shprehura në padi, dhe në seancë sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga dokumenti i titulluar “*formë për vizitë përmbushëse e datës 10.03.2021*” dhe “*vendimi nga zyra për gjoba dhe ndëshkime administrative nr.prot. 0260/2021 i datës 16.03.2021*”, ka vlerësuar si të drejtë konstatimin e të paditurit se tatimpaguesi këtu paditësi ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore të përcaktuara me Nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/L-223, neni 17 pika 1 i UA 15/2010 sipas të cilit të gjithë tatimpaguesit janë të obliguar të mbajnë librat dhe regjistrimet ashtu siç kërkohet me legjislacionin tatimor në fuqi dhe ndëshkohet sipas Nenit 53 (53.2.1) për shkak të mos krijimit dhe mos mbajtjes së dokumentacionit në vlerë prej 125.00€, e që lidhet me mos mbajtjen e librave dhe regjistrimeve siç kërkohet edhe me dispozitat e nenit 13, paragrafi 1, të ligjit 03/L-222, me të cilin përcaktohet se “*Tatimpaguesit janë të detyruar të mbajnë librat dhe regjistrat në pajtim me legjislacionin tatimor*”, tutje par 5, i këtij neni thekson ‘*Mallrat që posedon tatimpaguesi duhet të dokumentohen me dokumente mbi origjinën*’ dhe të dispozitave të nenit 17 dhe 19 UA 15/2010, dhe neneve 53, par. 2. “*Çdo person i nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrime, përfshirë kërkesën për të vendosur numrin fiskal të biznesit në të gjithë kuponët dhe faturat e lëshuara, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe i cili nuk e kryen këtë do t’i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ si vijon, nën paragrafi 2.4. tatimpaguesi me qarkullim vjetor prej pesëqind mijë (500,000) dhe më shumë – ndëshkim administrativ prej njëmijë (1,000)’* Euro. dhe neni 59 të këtij ligji ku thuhet se “*Kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomik posedon mallra pa origjinë ai person do t’i nënshtrohet ndëshkimit administrative me njëzetepesë për qind (25%) të vlerës së tregut së mallrave. Ato mallra mund të merren dhe të mbahen në kujdestari të ATK-së me qëllim të caktimit të detyrimit penal. Në këtë rast, do të ndiqen procedurat për vlerësim për rrezik në nenin 21 të këtij ligji, dhe procedurat e marrjes së mallit dhe shitja e tyre do të rregullohet me dispozitat e neneve 34, 35 dhe 36 të këtij ligji. Drejtori i Përgjithshëm mund të lëshojë një urdhër për rrezik sikurse është paraparë në nenin 39 të këtij ligji’*’.

Pretendimet e paditësit lidhur me përcaktimin e vlerës mesatare të kostos së mallit si pikë e cila e ka dëmtuar kompaninë, por e cila pikë nuk është trajtuar fare nga e paditura në vendimin kontestues, Gjykata sqaron se vepron vetëm në bazë të fakteve dhe provave të

administruara në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe me të drejtë e paditura konform gjendjes faktike të konstatuar sipas vizitës përmbushëse të datës 10.03.2021, e të dispozitave si më lartë, dhe në mungesë të fakteve dhe provave ka refuzuar kërkesën e tatimpaguesit këtu paditësit, në procedurë të ankesës, duke u bazuar në rekomandimet e cekura që: *“mbetet në të ardhmen që të analizohet në mënyrë të detajuar tërë dokumentacioni i biznesit pas kontrollit të fundit të përfunduar me periudhën 08/2018.”* Dhe tutje që: *“në bazë të dokumentacionit të ofruar nga tatimpaguesi si dhe informata shtesë në dispozicion është punuar kjo analizë. Me këtë nuk përjashtohet mundësia që ndonjë fakt tjetër i ofruar, të bëjë vlerësim shtesë për qarkullim dhe obligim tatimor shtesë edhe për periudhat që kanë qenë objekt i kësaj vizite, sipas Nenit 19 paragrafit 11 i Ligjit 03/L-222.”*

Nga kjo gjendje faktike, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Neni 43, par 1. i LKA-së, *“Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”*, andaj paditësi në këtë kontest tregtar administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështetë pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështetë kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin 81 F, paragrafi 1 dhe 81 E, paragrafi 4, pika 4 dh 5 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 .

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, parag, 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.220/22 datë 12.04.2024

Gj y q t a r j a
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.